



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË

NR. AKTI 2819

NR. VENDIMI 2467

V E N D I M
“NE EMER TE REPUBLIKES”

GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANË, E PERBERE NGA:

MARINELA OSMANI – GJYQTARE

Asistuar nga sekretare gjyqesore Valbona Maja, sot me date 27.03.2017, perfundoi ne seance gjyqesore me dyer te hapura, çeshtjen civile Nr.2819, qe i perket:

PADITES: Shoqeria “****”, shoqeri e te drejtes turke, me seli ne ***, perfaqesuar nga Av. ***, me license Nr. ***, Av. ***, me license perkatesisht Nr. *** dhe Av. ***, me license Nr. ***, zgjedhur me prokuren date ***.

TE PADITUR: ***, ***, me seli ne ***, perfaqesuar nga Av. ***, me license Nr. ***, zgjedhur me deklarim para Gjykates.

PERSONI I TRETË:Drejtoria e Përgjithshme e Markave dhe e Patentave, Adresa: Bulevardi “Zhan D’Ark” Ish shtepia e Ushtarakëve, Kati i IV Tiranë, perfaqesuar nga juristja ***, zgjedhur me autorizimin Nr. *** Prot., date 28.09.2016. (në mungesë)

OBJEKTI: 1. Pushim i cenimit te te drejtave industriale te paditesit qe i burojne nga markat “****”.

2. Ndalimi i te paditurit per te tregtuar produktet e markes e regjistruar “****”.

3. Heqja dhe bllokimi i te gjitha produkteve te markes “****” te cilat tregtohen ne menyre te parregullt nga pala e paditur.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr.9947, date 07.07.2008 “Per pronesine industriale”. Konventa e Parisit “Per mbrojtjen e pronesise industriale”, date 20.03.1883, nenet 4, 140-164, 167-171. Marreveshja e Madritit “Per rregjistrimin e markave tregtare” e vitit 1891.

Gjykata, në perfundim të shqyrtimit të çështjes civile si më lart,

pasi:

Degjoi:

Palen paditese Shoqeria “*”, perfaqesuar ne gjykim nga Av. ***, e cila perfundimisht kerkoi pranimin e padise sipas objektit; Palen e paditur ***, perfaqesuar nga Av. ***, i cili perfundimisht kerkoi rrezimin e padise si te pabazuar ne ligj dhe ne prova. Ia nenshtroi hetimit gjyqesor dhe çmoi provat e paraqitura dhe; Shqyrtoi çështjen ne teresi;**

V E R E N

1. Me padine drejtuar kesaj Gjykate, pala paditese Shoqeria “****”, kerkon: “1. Pushim i cenimit te te drejtave industriale te paditesit qe i burojne nga markat “****”. 2. Ndalimi i te paditurit per te tregtuar produktet e markes e regjistruar “****”. 3. Heqja dhe bllokimi i te gjitha produkieve te markes ' ****' te cilat tregtohen ne menyre te parregullt nga pala e paditur.”, objekt i pakesuar bazuar ne nenin 185 te Kodit te Procedurës Civile, ne senacen e dates 14.02.2017.

Gjate shqyrtimit gjyqesor rezultoi se:

2. Pala paditese Shoqeria “****”, eshte nje person juridik i regjistruar ne date 22.10.2003, si nje shoqëri e së drejtës tregtare turke. Si objekt te veprimtarisë se saj, eshte çdo materie elektrike dhe elektronike, drite, ndriçimi, pamjet dhe sistemet e kompjuterave, çdo lloj makine dhe pjeset e mjeteve te tyre, çdo lloji llampash dhe mjete te tjera qe bejne drite armature dhe çdo lloj te kablllove..... shitjet, blerjet e tyre, eksportimi dhe importimi i tyre etj.

3. Ndersa, pala e paditur ***, eshte nje person fizik tregtar, i regjistruar ne date 14.01.2016, me objekt te veprimtarise se tij, tregti me pakice te materialeve elektrike te ndryshme.

4. Në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe për nevoja të aktivitetit tregtar, pala paditese ka regjistruar ne baze te Protokollit te Madridit, ne Regjistrin Nderkombetar te Markave, markën tregtare “****”, fjale dhe logo, me datë regjistrimi 12.08.2005 dhe mbrojtje deri ne date 12.08.2025. Per qellime te regjistrimit te markes “****” sipas klasifikimit te Nices, eshte percaktuar klasifikimi nderkombetar i te mirave dhe sherbimeve te tregtuara nga pala paditese, ne klasat 09, 11 dhe 35. Ky fakt u pohua dhe nga personi i trete, i cili vendosi ne dispozicion te Gjykares, te dhenat e regjistrimit te markes nga regjistri nderkombetar.

5. Pala paditese nuk ka zyre perfaqesimi apo dege te saj ne territorin e RSH, por tregtimin e mallrave te saj ne Shqiperi e ka kryer nga viti 2015, nepermjet Shoqerise “****” shpk me te cilen pretendon se ka marreveshje ekskluziviteti, duke i dhene te drejten per te kryer importimin dhe tregtimin e te gjithe mallrave dhe produkteve te markes “****”.

6. Pala paditëse pretendon se pas është vënë në dijeni për përdorimin e markës tregtare në territorin shqiptar nga subjekte të paautorizuara prej saj. Një ndër këto subjekte, është aktiviteti që ushtron pala e paditur ***, person fizik tregtar, me objekt veprimtarie tregti me pakice të materialeve elektrike të ndryshme.

7. Pala paditëse pretendon se i pretendon se i padituri tregton produkte nën markën “***”, të cilat kanë të njëjten pamje vizuale, të njëjtat ngjyra dhe janë të njëjta produkte, llampa elektrike ndriçimi me konsum të ulet.

8. Pala paditëse provoi se është paraqitur tek pala e paditur dhe ka blere kundrejt kuponit tatimor llampa ekonomike, të cilat janë produkte nën markën, fjale dhe logo, “***”. Pala e paditur nuk provoi se tregtimi i këtyre produkteve ishte bere në kunader të një marreveshje me palen paditëse apo subjekte të cilat kishin marreveshje me këte të fundit për tregtime të llampave nën markën, fjale dhe logo, “***”.

Ne lidhje me parashikimet ligjore, Gjykata verën se:

9. Në Ligjin Nr. 9947 07. 07. 2008 “Për Pronësinë Industriale” neni 140 parashikon se: “Çdo shenjë ose kombinim shenjash, që paraqitet grafikisht dhe që shërben për të dalluar mallrat apo shërbimet e një personi fizik ose juridik, nga ato të një personi tjetër fizik ose juridik, është markë që përfaqëson ato mallra ose shërbime, me kusht që të përmbushen kërkesat e neneve 141 deri në 143 të këtij ligji (në vijim do të quhet “markë”). 2. Përbëjnë marka shenjat e mëposhtme: a) fjalët, përfshirë emrat personalë, shkronjat, numrat, shkurtimet; b) shenjat figurative, përfshirë vizatimet; c) format dy ose tredimensionale, format e mallrave dhe/ose ambalazhimi i tyre; ç) kombinimet e ngjyrave e të dritë-hijeve, si dhe ngjyrat në vetvete; d) çdo kombinim i shenjave, të përmendura nga shkronjat “a” deri në “ç” të kësaj pike. 3. Markat regjistrohen vetëm nëse ato mund të paraqiten grafikisht. Kjo lidhet veçanërisht me lloje të veçanta markash, si zëri dhe sinjalet e dritës, por jo vetëm me këto.”

10. Neni 156 i ligjit Nr.9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” percakton të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi: “1. Pronari i markës së regjistruar gëzon të drejtën ekskluzive të përdorimit të markës, në përputhje me të drejtat e parashikuara në këtë ligj. 2. Pronari i markës së regjistruar gëzon të drejtën të ndalojë personat e tretë të përdorin, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre tregtare, pa autorizimin e tij: a) një shenjë, që është e njëjtë me markën, për mallra dhe shërbime, që janë të njëjta me ato, për të cilat është regjistruar marka; b) një shenjë, që është e njëjtë ose e ngjashme me markën apo që, për shkak të njëjlojshmërisë apo ngjashmërisë së mallrave ose shërbimeve, për të cilat përdoret shenja, me mallrat apo shërbimet, që mbulohen nga marka e regjistruar, mund të shkaktojnë konfuzion të publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes së shenjës me markën tregtare; c) një shenjë të njëjtë ose të ngjashme për mallra apo shërbime, edhe kur këto nuk janë as të njëjta e as identike me ato, për të cilat është regjistruar marka, në rast se marka ka reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe nga përdorimi i shenjës, pa shkak të arsyeshem, realizohet një përfitim i padrejtë ose dëmtohet natyra dalluese apo emri i mirë i markës....”

11. Neni 167 i ligjit parashikon procedurat kundër shkeljes së të drejtave: “1. Aplikanti, pronari i markës së regjistruar, personi i licencuar, përdoruesi i autorizuar i një marke

kolektive ose çdo person tjetër, të drejtat e të cilit, të parashikuara në dispozitat e këtij ligji, shkelen, mund të ngrenë padi në gjykatë kundër shkeljes së të drejtave. Për qëllim të këtij kapitulli, pronarët e markave, që janë të mirënjohura në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së Parisit, në përputhje me shkronjën "ç" të pikës 5 të nenit 143 të këtij ligji, gëzojnë të njëjtat të drejta, që gëzojnë pronarët e markave të regjistruara. 2. Çdo përdorim, kufizim, imitim ose bashkëshoqërim i paautorizuar, që bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, përbëjnë shkelje të së drejtës së markës së regjistruar ose të një marke, për të cilën është paraqitur një aplikim për regjistrim, sipas ligjit. 3. Personi, sipas kuptimit të pikës 1 të këtij neni, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës kundër çdo personi, që shkel të drejtat e tij, për të kërkuar: a) ndalimin e veprimeve të tjera në shkelje të të drejtave; b) heqjen ose bllokimin e objekteve, që përbëjnë shkelje të të drejtave, nga qarkullimi civil ose, nëse nuk ka rrugë tjetër, shkatërrimin e këtyre objekteve; c) heqjen ose bllokimin e mjeteve të përdorura ekskluzivisht apo pothuajse ekskluzivisht për krijimin ose prodhimin e produkteve që përbëjnë shkelje apo, nëse nuk ka rrugë tjetër, shkatërrimin e tyre; ç) publikimin e vendimit përfundimtar të gjykatës në median publike me shpenzimet e personit që ka kryer shkeljen, në mënyrën e parashikuar nga gjykata. 4. Shkelësi është përgjegjës për të gjitha dëmet që i janë shkaktuar paditësit. Gjykata, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, vendos masën e dëmshpërblimit, përveç kur është parashikuar ndryshe dhe mund, sipas rastit: a) të marrë parasysh të gjitha aspektet përkatëse, siç janë pasojat negative ekonomike, përfshirë fitimet e munguara, që ka pësuar pala e dëmtuar, çdo fitim të padrejtë, të realizuar nga shkelësi dhe, sipas rastit, elemente të tjera përveç faktorëve ekonomikë, si dëmi moral, që i është shkaktuar mbajtësit të të drejtave nga shkelja; b) të vendosë kompensimin e dëmeve me shuma të menjëhershme, në bazë të elementeve, si shuma e të ardhurave ose tarifave, që do të siguroheshin apo merreshin, në rast se shkelësi do të kishte kërkuar autorizim për përdorimin e së drejtës së pronësisë intelektuale në fjalë. 5. Padia kundër shkeljes së të drejtave duhet të depozitohet në gjykatë brenda 3 vjetëve nga data, kur paditësi merr dijeni për shkeljen dhe shkelësin.”

12. Neni 184/a i ligjit precakton te drejtes për të vepruar kundër shkeljes së të drejtave: “1. E drejta për të ngritur padi në gjykatë për shkelje të të drejtave, sipas këtij ligji, i përket: a) pronarit të një patente, disenjoje ose markë të regjistruar;...”.

13. Neni 184/b parashikon procedurat në rast shkeljeje: “1. Personat e përmendur në nenin 184/a, të këtij ligji, kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës kundër çdo personi, që shkel të drejtat e tyre për të kërkuar: a) ndalimin e veprimeve të mëtejshme që përbëjnë shkelje të të drejtave; b) heqjen ose bllokimin e objekteve, që përbëjnë shkelje të të drejtave nga qarkullimi civil ose shkatërrimin e këtyre objekteve; c) heqjen ose bllokimin e mjeteve të përdorura ekskluzivisht ose pothuajse ekskluzivisht për krijimin apo prodhimin e produkteve, që përbëjnë shkelje ose shkatërrimin e tyre; ç) publikimin e vendimit përfundimtar të gjykatës në median publike me shpenzimet e personit që ka kryer shkeljen, sipas mënyrës së parashikuar nga gjykata. 2. Gjykata urdhëron zbatimin e masave të parashikuara në pikën 1, shkronjat "b" dhe "c", të këtij neni, me shpenzimet e shkelësit, përveç kur ka arsye të veçanta për të vendosur ndryshe. Në shqyrtimin e kërkesës për marrjen e masave të parashikuara në pikën 1, shkronjat "b" dhe "c", gjykata vlerëson proporcionalitetin midis rëndësisë së

shkeljes dhe masës së urdhëruar, si dhe interesat e palëve të treta. 3. Masa e parashikuar në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni, mund të merret edhe ndaj një ndërmjetësi, shërbimet e të cilit përdoren nga një palë e tretë për të shkelur një të drejtë të pronësisë industriale. 4. Padia kundër shkeljes së të drejtave duhet të depozitohet në gjykatë, brenda tre vjetëve nga data kur paditësi merr dijani për shkeljen dhe shkelësin.”

14. Neni 184/c i ligjit parashikon shpërblimi i dëmeve: “Shkelësi është përgjegjës për të gjitha dëmet që i janë shkaktuar paditësit. Gjykata, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, vendos për masën e dëmshpërblimit, përveç kur është parashikuar ndryshe. Gjykata, në caktimin e masës së dëmshpërblimit: a) mban parasysh çdo dëm efektiv dhe real, përfshirë edhe fitimin e munguar, që ka pësuar pala e dëmtuar, çdo fitim të padrejtë, të realizuar nga shkelësi, si rezultat i konkurrencës së pandershme dhe, sipas rastit, edhe dëmin moral shkaktuar mbajtësit të të drejtave nga shkelja, cenimin e emrit apo të reputacionit të tij tregtar etj.; b) sipas rastit, mund të vendosë shpërblimin e menjëhershëm të dëmit duke llogaritur fitimet që do të siguroheshin ose do të merreshin në rast se shkelësi do të kishte kërkuar autorizim për përdorimin e së drejtës së pronësisë industriale në fjalë.”.

Ne perfundim, pas analizës së faktit, pretendimeve dhe prapësimeve të palëve ndërgjyqese dhe analizës së parashikimeve në ligj, bazuar në nenin 16 të Kodit të Procedurës Civile dhe në vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë Nr.3, datë 29.03.2012, Gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj duke zgjidhur çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar.

15. Marka tregtare përfaqëson një nga format e pronësisë industriale dhe në interpretim të normave ligjore në fuqi dhe të detyrueshme për zbatim, Gjykata sqaron se me termin pronë do të kuptohen një sërë interesash ekonomike në funksion të qëllimit të të drejtës së pronës, duke përfshirë për këtë pronën e luajtshme dhe të paluajtshme, interesat pasurore dhe jo pasurore.

16. Pala paditëse Shoqëria “***” është pronare e ligjshme e markës tregtare “***”, e regjistruar në baze të Protokollit të Madridit, në Regjistrin Nderkombëtar të Markave, me datë rregjistrimi 12.08.2005 dhe mbrojtje deri në datë 12.08.2025. Si rrjedhojë, pala paditëse në cilësinë e pronarit të kësaj marke tregtare ka legjitimitetin real aktiv t’i drejtohet Gjykatës me padi, për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë mbi markën tregtare, nga cenimi që mund t’i behet nga te treta.

17. Gjate gjykimi u provua se nga pala e paditur ***, ***, rezulton të ketë qene tegtues i llampave nën marken “***”, të cilat kanë të njëjten pamje vizuale, të njëjtat ngjyra dhe janë të njëjta produkte, llampa elektrike ndriçimi me konsum të ulët, me ato që tregton dhe pala paditëse.

18. Bazuar në nenin 156 të ligjit Nr.9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, veprimi i kryer nga ana e palës së paditur bie në kundërshtim me ligjin, pasi vetëm pronari i

markës së regjistruar ka të drejtën ekskluzive të përdorimit të saj. Rezultoi e provuar se pala paditëse është pronar i regjistrimit për markën “***” në Klasën 09, 11 dhe 35 sipas Klasifikimit të Nicës.

19. Marka e regjistruar nga pala paditëse dhe produktet e tregtuara nga pala e paditur në ambientet ku ushtron veprimtarinë tregtare, për kohën e përdorur, janë identike, shenjat janë ekstremisht të ngjashme. Fjalët janë të stilizuara në të njëjtën mënyrë; kanë të njëjtën strukturë dhe kanë të njëjtin kuptim leksikologjik. Gjithashtu, vendosja e fjalëve, kuptimi dhe informacioni që ato përcjellin janë identike. Kjo lloj ngjashmërie përbën burim konfuzioni tek konsumatori në lidhje me markën tregtare dhe me produktet dhe cilësitë që përfaqëson.

20. Bazuar në nenin 140 të ligjit, marka tregtare e regjistruar është e paraqitur grafikisht, përmban elementët thelbësorë me karakter dallues për të diferencuar dhe arritur tek konsumatori me synimin që ky i fundit të mund të dallojë këtë markë nga një tjetër. Marka “***” është regjistruar në përputhje me pikën 1, 2 (a,d) të nenit 140 si dhe pikës 3 të tij pasi është paraqitur në formë grafike, si fjale dhe kombinim ngjyrash. Qëllimi i markës tregtare është krijimi i një përjasjeje të konsumatorit ose me saktë lidhja që vjen midis markës dhe produktit që ai tregon e përkthyer me pas në reputacion të saj në qarkullimin tregtar.

21. Mallrat që ofrohen nga palët ndërgjyqëse kanë qene të njëjta dhe në këto kushte prezumohet se kanë sjelle konfuzion tek konsumatori. I padituri ***, ***, rezulton të ketë qene përdorues i paautorizuar i Markës tregtare “***”, gjë që rezulton si nga blerja e produktit me kupon tatimor ashtu dhe nga deklaratimet ndaj pyetjeve të Gjykatës dhe pales paditëse sipas nenit 182 të Kodit të Procedurës Civile.

22. Nenit 10 bis pika 3 Konventa e Parisit 1883 detyron vendet anëtare të ndalojnë të gjitha veprimet që bien ndesh me praktika tregtare të tilla sa konfuzioni merret i mirëqënë, gjendje kjo që krijon mbrojtje të gjerë përfshirë markën tregtare, shenjat dalluese, etiketat, shfaqjet ambalazhuese, formë ose ngjyrë të mallrave, apo çdo tregues tjetër të mallrave që përdoret nga një biznesmen.

23. Sa me lart, Gjykata çmon se padia është e bazuar në prova dhe në ligj dhe si e tillë ajo duhet të pranohet. Bazuar në nenin 106 të Kodit të Procedurës Civile, shpenzimet gjyqësore të provuara gjatë këtij gjykimi janë në ngarkim të pales paditëse ***.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 306 - 310 të Kodit të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

1. Pranimin e padisë se pales paditëse Shoqëria “***”.
2. Pushimin e cenimit të pronesi me anë të ndalimit të përdorimit të metejshëm dhe në të ardhmen, në mënyrë të paautorizuar të markës tregtare “***”, nga ana e *** **.
3. Heqjen dhe bllokimin e llampave, nën logon dhe markën “***”, që tregtohen në mënyrë të paautorizuar nga ana e personit fizik tregtar ***.
4. Leshimin e urdherit të ekzekutimit për këtë vendim gjyqësor.
5. Shpenzimet gjyqësore të ngarkohen pales se paditur ***.

6. Kunder vendimeve lejohet te behet ankim brenda 15 diteve nga dita e neserme e shpalljes se vendimit ne Gjykatën e Apelit Tirane. Per personin e trete ne mungese ky afat fillon nga dita e neserme e njoftimit te vendimit.

U shpall ne Tirane, sot me date 27.03.2017

SEKRETARE
GJYQTARE
VALBONA MAJA
MARINELA OSMANI

Shpenzime gjyqesore

Takse gjyqesore

*** leke

Shpenzime te tjera

*** leke

Shperblim avokati paditesi

*** leke

Shperblim avokati paditesi

*** leke

Njoftime

*** leke

Sekretare: Valbona Maja